

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Raporti i dytë i Vlerësimit të të Drejtave të
Komuniteteve

Dhjetor, 2010

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
1. HYRJE	2
2. TRASHËGIMIA KULTURORE DHE FETARE	3
3. ARSIMI.....	6
4. PËRDORIMI I GJUHËVE	10
5. PJESËMARRJA	13
6. KTHIMI DHE RIINTEGRIMI	16
7. PËRFUNDIME	19
8. REKOMANDIMET.....	21

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

Mendimi i Komitetit Këshillues: Komiteti Këshillues Për Konventën Kornizë Për Mbrojtjen E Pakicave Kombëtare, Mendimi për zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë, ACFC/OP/I(2005)004, Strasburg, 2 mars 2006.

Rekomandimi i Këshillit të Evropës: Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me zbatimin e Konventës Kornizë në Kosovë

ZNKE: Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

EULEX: Misioni Evropian për Sundim të Ligjit

Konventa Kornizë: Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

MKRS: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MASHT: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MMPH: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MKK: Ministria për Komunitete dhe Kthim

OSBE: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Misioni në Kosovë

IPVQ: Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes

Komisioni i Rindërtimit: Komisioni për zbatimin e rindërtimit të monumenteve fetare ortodokse serbe

UNDP: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNESCO: Organizata për Arsimo, Shkencë dhe Kulturë e OKB-së

UNHCR: Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë

UNICEF: Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

UNMIK: Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

USAID: Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në dhjetor të vitit 2009, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE), publikoi Raportin e Vlerësimit të të Drejtave të Komuniteteve¹, i cili analizonte përparimin e bërë nga institucionet e Kosovës në zbatimin e standardeve të veçanta të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare² (Konventa Kornizë). Qysh prej publikimit të raportit të parë të vlerësimit, OSBE-ja ka vëzhguar përpjekjet e institucioneve të Kosovës në realizimin e rekomandimeve të dhëna në Mendimin e Komitetit Këshillues³ dhe të atyre të dhëna në raportin e parë të vlerësimit të OSBE-së.

Ky raport, i cili mbulon periudhën korrik 2009 - qershor 2010⁴ dhe përqendrohet në fushat tematike të kulturës, arsimit, gjuhëve, pjesëmarrjes në jetën publike si dhe në kthimin e riintegrimin, arrin në përfundim se institucionet e Kosovës kanë bërë disa hapa në drejtim të avancimit të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve joshumicë në gjitha fushat tematike të vlerësuara⁵. Ndër këta hapa janë edhe sigurimi i librave shkollorë pa pagesë për nxënësit që vijojnë arsimin e detyrueshëm, hartimi i planprogramit në gjuhën rome, themelimi i mekanizmave të pjesëmarrjes në nivel lokal, përkushtimi ndaj mbylljes së kampeve të kontaminuara me plumb në veri të Mitrovicës/Mitrovica, miratimi i “Strategjisë së Rishikuar për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar⁶”, rindërtimi i disa kishave ortodokse serbe si dhe përkthimi i dokumenteve zyrtare në gjuhët në përdorim zyrtar. Të gjitha këto iniciativa shfaqin përkushtimin ndaj zbatimit të rekomandimeve të Komitetit Këshillues lidhur me Konventën Kornizë.

Shumë probleme dhe sfida tanimë të theksuara në raportin e mëparshëm, megjithatë, vazhdojnë të ndikojnë mbi komunitetet joshumicë në realizimin e të drejtave të tyre kulturore, arsimore dhe gjuhësore, si dhe të drejtës së tyre për pjesëmarrje dhe për kthim e riintegrim. Raporti ofron një numër gjetjesh në këtë kuptim, për secilën nga fushat tematike të trajtuara. Në lidhje me të drejtat kulturore, raporti gjen se korniza ligjore për trashëgiminë kulturore nuk zbatohet, si dhe nuk është hartuar lista e monumenteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, duke rrezikuar kështu seriozisht monumente të shumta kulturore dhe fetare. Në lidhje me të drejtat në arsim, nuk ka përmirësime të konsiderueshme në lidhje me ndërveprimin mes nxënësve nga komuniteti shqiptar dhe serb, e as nuk ka mësimdhënie në të dyja gjuhët zyrtare. Për më tepër, nuk ka mundësi për nxënësit që të arsimohen në gjuhën serbe sipas

¹ Raporti i OSBE-së *Vlerësimi i të Drejtave të Komuniteteve* (Dhjetor, 2009). http://www.osce.org/documents/mik/2009/12/41986_en.pdf.

² Këshilli i Evropës, “Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, Strasburg, 1 shkurt 1995.

³ Komiteti Këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Mendimi mbi Zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë (Mendimi i Komitetit Këshillues), ACFC/OP/I(2005)004, Strasburg, 2 mars 2006. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Komiteti Këshillues nxori Mendimin e dytë mbi Zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë (Mendimi i dytë), ACFC/OP/II(2009)004, Strasburg, 31 maj 2010.

⁴ Zhvillimet e reja lidhur me ngjarjet më relevante e që kanë ndodhur jashtë periudhës për të cilën raportohet janë ofruar gjithashtu.

⁵ Për qëllime të këtij raporti, komunitetet joshumicë janë të gjitha ato komunitete që përbëjnë pakicë numerike në nivel komunal në Kosovë.

⁶ Në prill të vitit 2010, Qeveria e Kosovës miratoi “Strategjinë e Rishikuar për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar” dhe “Strategjinë për Komunitete dhe Kthim 2009-2013”.

kurrikulës së Kosovës⁷. Në fushën e të drejtave gjuhësore, nuk është trajtuar ndarja joadekuate e resurseve për sigurimin e përkthimit cilësor të dokumenteve zyrtare dhe përkthimin gjatë takimeve, gjë që ndikon në të drejtat gjuhësore të komuniteteve joshumicë. Në lidhje me pjesëmarrjen në jetën publike, qasja publike si dhe e drejta e pjesëmarrjes në çështje publike mbetet e kufizuar dhe përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në shërbimin civil është ende i pamjaftueshëm.

Raporti konkludon se janë bërë pak hapa për rregullimin e vendbanimeve joformale, si dhe niveli i zbatimit të “Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian”⁸ është i ulët. Gjithashtu, në lidhje me kthimin dhe riintegrimin, duket që qëndrueshmëria e kthimit mbetet sfidë për shkak të një numri faktorësh, si qasja e kufizuar ndaj pronës, integrimi ekonomik si dhe siguria reale apo e perceptuar fizike e të kthyerve; mungesa e fondeve dhe bashkërendimi në lidhje me çështjen e riatdhesimit i lë të kthyerit e detyrueshëm pa shkallën e domosdoshme të mbrojtjes dhe ndihmës.

1. HYRJE

Pas miratimit të një kornize gjithëpërfshirëse ligjore, institucionet e Kosovës kanë pasur kohë adekuate për t’i themeluar mekanizmat e domosdoshëm për të siguruar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë, ashtu siç parashihet me kornizën gjithëpërfshirëse ligjore të miratuar qysh në fillim të vitit 2008. Gjatë periudhës së raportimit, janë shpallur vetëm disa akte legislative me efekt të qartë dhe të drejtpërdrejtë në komunitetet joshumicë në kuptimin e fushëveprimit të këtij raporti. Kështu, janë miratuar ligje për mbrojtjen e të dhënave personale⁹, shërbimin civil¹⁰ dhe ripranimin e personave të riatdhesuar.¹¹ Qeveria e Kosovës gjithashtu ka miratuar një numër dokumentesh parimore në lidhje me të, duke përfshirë një plan veprimi¹², strategjitë dhe një plan operativ.¹³

Ky vlerësim i dytë mbulon fushat tematike të kulturës, arsimit, gjuhëve, pjesëmarrjes në jetën publike, si dhe kthimit dhe riintegrimin. Këto pesë tema janë përzgjedhur për shkak të rëndësisë së tyre qenësore në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Arsimi është një prej mjeteve kryesore për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave. E drejta për t’u kthyer dhe për të marrë pjesë lirisht në jetën publike përfshijnë të drejtat themelore të komunitetit dhe ato të njeriut, derisa trashëgimia kulturore dhe përdorimi i gjuhëve janë elemente thelbësore për shprehjen e identitetit të komunitetit.

Raporti bazohet në aktivitetet e rregullta të monitorimit të OSBE-së në nivel qendror dhe lokal gjatë periudhës korrik 2009 – qershor 2010, intervistat me zyrtarët qendrorë dhe lokalë si dhe hulumtimet në terren të kryera nga ekipet e OSBE-së në terren nëpër

⁷ Arsimimi në gjuhën serbe është në dispozicion në shkollat e drejtuara nga Serbia.

⁸ Më 24 dhjetor 2008, qeveria e Kosovës e miratoi “Strategjinë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2009-2015”.

⁹ Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr. 03/L-172, 13 maj 2010.

¹⁰ Ligji për Shërbimin Civil, nr. 03/L-149, 14 qershor 2010.

¹¹ Ligji për Ripranim, Nr. 03/L-208, 12 korrik 2010.

¹² Më 24 dhjetor 2009, Qeveria e Kosovës miratoi Planin e Veprimit për zbatimin e “Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas 2009 – 2015”.

¹³ Më 26 maj 2010, Qeveria e Kosovës miratoi “Planin operativ për zhvendosjen e familjeve rome, ashkali dhe egjiptase të zhvendosura brenda një vendi, nga kampet e kontaminuara me plumb Osterode dhe Česmin Lug”.

komuna. Secili kapitull përfshin një pasqyrë të gjetjeve të Raportit të Vlerësimit të Drejtave të Komuniteteve të OSBE-së të vitit 2009, si dhe rekomandimet gjegjëse të mendimit të parë të Komitetit Këshillues. Kapitulli, pastaj, vazhdon me analizimin e gjendjes në terren, duke theksuar përparimet dhe ngjarjet relevante gjatë periudhës për të cilën raportohet në krahasim me raportin e kaluar, si dhe jep një vlerësim të sfidave që vazhdojnë të mbesin për institucionet e Kosovës.

2. TRASHËGIMIA KULTURORE DHE FETARE

Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë, Rekomandimi nr. 13: Të zgjerohen përpjekjet për mbrojtjen e monumenteve fetare nga incidentet e mundshme, duke vazhduar procesin qenësor të rindërtimit të monumenteve të dëmtuara ortodokse serbe.¹⁴

Gjetjet e raportit të vitit 2009

Mbrojtja dhe ruajtja e monumenteve të trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve nga vandalizmi, dëmtimi, shkatërrimi, si dhe ndërtimet e ligjshme apo të paligjshme, mbetet ende një brengë e veçantë. Ngjashëm me këtë, niveli i ulët i zbatimit të kornizës përkatëse ligjore, si dhe bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërmjet zyrtarëve komunalë, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, si dhe Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, i ekspozon monumentet e trashëgimisë kulturore dhe fetare ndaj cenueshmërisë.

Gjendja në terren

Më 12 shkurt 2009, policia e Kosovës lëshoi një urdhër operativ për të marrë përsipër sigurimin dhe mbrojtjen e 17 monumenteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore dhe dha udhëzime lidhur me përgjegjësitë përkatëse të drejtorive rajonale, stacioneve të policisë dhe njësisë të policisë së Kosovës.¹⁵ Më 18 mars 2010, monumenti i Gazimestanit, në komunën e Obiliqit/Obilić që ruhej nga KFOR-i u vendos nën monitorimin e sigurisë nga policia e Kosovës. Me kërkesë të Kishës Ortodokse Serbe, disa prej këtyre monumenteve mbeten në mbrojtje të KFOR-it.¹⁶ Më 23 gusht, policia e Kosovës mori përgjegjësitë lidhur me sigurinë për Manastirin e Gračanica/Gračanicës nga KFOR-i dhe vlerësimi i sigurisë për këta muaj mund të konsiderohet si i kënaqshëm. Ndonëse incidentet që kanë si cak kishat dhe varrezat vazhdojnë të ndodhin, përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe e përshkruajnë gjendjen e përgjithshme të sigurisë në ato vende nën mbrojtjen e policisë si të pranueshme. KFOR-i ka ngritur disa vërejtje ndaj dorëzimit të mëtutjeshëm të

¹⁴ Rekomandimet në fillim të çdo kapitulli u referohen atyre të dhëna nga Komiteti Këshillues i Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, gjegjësisht në Mendimin e parë të tij mbi Zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë, ACFC/OP/I(2005)004, Strasburg, 2 mars 2006, dhe atyre në Rezolutën ResCMN(2006)9 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, të miratuar më 21 qershor 2006.

¹⁵ Në rajonin e Prizrenit: Kisha e Virgjërëshës së Shenjtë Ljeviška; Kisha Episkopale si dhe kompleksi i Katedrales së Shën Gjergjit; Kisha e Shën Nikollës; Kisha e Vjetër e Shën Gjergjit; Shkolla e Mesme Fetare Ortodokse; si dhe Kisha e Shën Qiriaqit; në rajonin e Prishtinës/Priština: Kisha e Shën Nikollës; Kisha e Shën Mikelit; Kisha e Shën Andreut. Në rajonin e Pejës/Peć: Kisha e Shën Pjetrit dhe Palit; Kisha e Shën Gjonit Pagëzuesit; objekti i Kishës së Nënës së Shenjtë – Kisha e vjetër. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica: Kisha e Shën-Eliasit dhe Kisha e Shën Savës. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane: Kisha e Mbretit të Shenjtë Urosh. Më shumë hollësi për këtë mund të gjeni në: <http://www.rickosovo.org/RIC%20-english/index.htm>.

¹⁶ KFOR-i vazhdon të ofrojë siguri në Manastirin e Deçanit/Visoki Dečani, Patriarkanën e Pejës/Peć, Manastirin Gorioç në Istog/Istok, Manastirin e Budisalcit/Budisavci në Klinë/Klina, atë të Shën Arangjelit dhe Shën Qiriaqit në Prizren, Manastirin e Deviçit në Skenderaj/Srbica dhe Manastiri e Sokolicës në Zvečan/Zveçan.

monumenteve dhe, përkundër asaj që procedurat e bartjes së përgjegjësive për monumentet e mbetura janë përfunduar tanimë, KFOR-i preferon të mos bëjë publike ato aranzhime dhe emrat e monumenteve që janë në proces të transferimit tek policia.

Komisioni për Implementimin e Rindërtimit (Komisioni i Rindërtimit)¹⁷ rifilloi aktivitetet e tij dhe ka përfunduar punët e rindërtimit në dy monumente, gjegjësisht Kishës së Shën Nikollës në Prishtinë/Priština si dhe Kishës Levishka në rajonin e Prizrenit. Përveç tyre, punimet në Kishën e Shën Eliasit në Vushtrri/Vučitrn, Kishën e Lumturimit të Virgjëreshës së Shenjtë në Gjakovë/Đakovica si dhe Kompleksin e Katedrales së Shën Gjergjit në Prizren do të përfundojnë së shpejti. Për më tepër, riparimi i kambanës dhe pastrimi i pusit në Manastirin e Deviçit në Skenderaj/Srbica, punimet në kopshtin e Kishën Episkopale të Shën Gjergjit në Prizren dhe në riparimin e Shën Gjonit Pagëzuesit në Pejë/Peć si dhe rindërtimi i ndërtesës së pranimit të miqve dhe murit rrethues priten të përfundohen deri në fund të vitit 2010. Më 8 prill 2009, Organizata e OKB-së për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) hapi një tender për rindërtimin dhe restaurimin e Kishës së Shën Savës në jug të Mitrovicës/Mitrovica si dhe Kishës së Shën Arangjelit Mikel në Shtime/Štimlje. Pas përfundimit të punëve, më 5 prill 2010, përfaqësuesit e Eparkisë së Rashkës – Prizrenit, Peshkopët Atanasije dhe Teodosije patën mbajtur liturgjinë e Pashkëve në Kishën e Shën Savës, me rreth 250 serbë pjesëmarrës.

Disa komuna¹⁸ kanë bërë hapa konkretë në ruajtjen e varrezave ortodokse brenda territoreve të tyre si dhe kanë ndarë fonde për mirëmbajtjen e tyre. Shpeshherë pastrimi është përcjellë me rrethim të varrezave për mbrojtje kundër akteve të mundshme të vandalizmit. Megjithatë, komunat kanë ndërmarrë këto iniciativa pa konsultime paraprake me përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe.

Çështjet e mbetura

Mospërmbushja e vazhdueshme nga institucionet e Kosovës e parimeve dhe dispozitave që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave kulturore dhe fetare ka mbetur çështje brengosëse gjatë periudhës së raportimit. Lista e monumenteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ende nuk është hartuar dhe dorëzuar për miratim në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturor.¹⁹ Deri më tani, vetëm 11 komuna²⁰ i kanë miratuar planet hapësinore komunale, të cilat janë thelbësore për rregullimin e ndërtimit dhe zhvillimit përreth zonave të veçanta të mbrojtura dhe monumenteve tjera të trashëgimisë kulturore. Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka themeluar Këshillin për Monitorimin e Zbatimit, me mandat të monitorimit dhe lehtësimit të zbatimit të

¹⁷ Pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në qershor 2004, Misioni i OKB-ve për Administrim të Përkohshëm në Kosovë (UNMIK) si dhe përfaqësuesi i Kishës Ortodokse Serbe kanë themeluar Komisionin e Rindërtimit për të menaxhuar dhe mbikëqyrur kryerjen e punimeve të rindërtimit emergjent në 11 kisha ortodokse serbe të dëmtuara rëndë gjatë trazirave të marsit 2004. Aktualisht, Komisioni i Rindërtimit ka në përgjegjësinë e vet 34 monumente. Kisha Ortodokse Serbe ndërpreu bashkëpunimin me institucionet e Kosovës në vitin 2008 dhe rifilloi bashkëpunimin teknik në mes të vitit 2009. Si rezultat i kësaj, më 8 qershor 2009, Komisioni i Rindërtimit ka qenë në gjendje të hapë tender të ri për rindërtim.

¹⁸ Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Mitrovicë/Mitrovica, Shtime/Štimlje dhe Lipjan/Lipljan.

¹⁹ Neni 4(3), Ligji për Trashëgiminë Kulturorë Nr. 02/L-88, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/52, 6 nëntor 2006.

²⁰ Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Pejë/Peć, Istog/Istok, Mitrovicë/Mitrovica, Glogovc/Glogovac, Deçan/Dečane, Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić, Vushtrri/Vučitrn.

ligjit të zbatueshëm për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.²¹ Ligji për zonën e veçantë të mbrojtur të qendrës historike të Prizrenit është ende në proces të hartimit qysh prej fundit të vitit 2009.

Mungesa e zbatimit efektiv të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore i ka lënë monumentet e kulturës të cenueshme në disa raste. Më 26 qershor 2009, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve ka miratuar projektin e komunës së Vushtrrisë/Vučitrn për të ndërtuar një restorant brenda zonës së veçantë të mbrojtur përreth urës mesjetare të Vojnoviqit. Aktivitetet e tilla janë të kufizuara dhe mund të miratohen vetëm nga Këshilli i Monitorimit të Implementimit, por ky Këshill nuk është themeluar ende. Rrjedhimisht, më 30 korrik 2009, komuna dha tokën ndërtimore brenda zonës së veçantë të mbrojtur, shpalli tenderin dhe nënshkroi kontratën me ofertuesin e suksesshëm më 30 nëntor 2009. Ndërtimet në monument janë afër përfundimit.²² Mungesa e masave të duhura që sigurojnë mbrojtje adekuate dhe mirëmbajtje të monumenteve të trashëgimisë kulturore kanë çuar në shkatërrim gati të plotë të ndërtesës së Hotel Union-it në Prishtinë/Priština më 22 gusht 2009. Policia kishte vlerësuar që një i pastrehë kishte ndezur një zjarr brenda ndërtesës, që më vonë ishte bërë i pakontrollueshëm. Më 17 maj 2010, pas lëshimit të një lejeje të ndërtimit për Bashkësinë Islame, Xhamia Hatunije në Prishtinë/Priština që i takon epokës Osmane është shkatërruar plotësisht. Bashkësia Islame kishte synuar ta ndërtonte një xhami të re në vendin e të vjetrës. Më 10 qershor 2010, komuna e Prishtinës/Priština e bëri publik qëllimin e saj për ta rrënuar monumentin e “Bashkim Vëllazërimit” të epokës jugosllave, që gjendet afër ndërtesës së qeverisë, dhe për ta ndërtuar një përkujtimore për Adem Jasharin, luftëtarin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Më 4 qershor 2010, me kërkesë të turqve të Kosovës në Dobërçan/Dobrčane²³, intervenimi personal i ambasadorit turk shmangu fillimisht shkatërrimin e plotë të xhamisë së kohës së Perandorisë Osmane në fshat. Si rrjedhim, më 8 qershor 2010, MKRS-ja i udhëzoi institucionet e nivelit lokal dhe qendror që ta pezullojnë lëshimin e lejeve të rrënimit dhe rindërtimit për objekte të trashëgimisë kulturore.²⁴ Përkundër ndalesës, xhamia në Dobërçan/Dobrčane u rrënuar përfundimisht më datën 30 qershor 2010. Kështu, në mungesë të një liste të miratuar të monumenteve të mbrojtura me ligj si dhe në mungesë të koordinimit mes zyrave qendrore dhe rajonale të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, duket se vendimi i MKRS-së nuk do të zbatohet.

Gjatë periudhës së raportimit kanë ndodhur një numër incidentesh, të cilat kanë prekur objektet kulturore dhe fetare, sidomos kishat dhe varrezat ortodokse serbe. Në nëntor të vitit 2009, Kisha Ortodokse në fshatin Donja Budriga/Budrikë e Poshtme²⁵ është plaçkitur, ku është vjedhur një sasi e konsiderueshme e bakrit nga dy kupolat dhe dritaret e kishës, një ibrik për pagëzim i bakrit dhe disa skele të çelikut. Më 18 mars

²¹ Shih Neni 4 i Ligjit Nr. 03/L-39 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, shkurt 2008.

²² Vlen të përmendet që arsyetimi i dhënë nga komuna dhe MKRS-ja për ta mbështetur projektin ishte që të përmirësohet mbrojtja, qasja dhe admirimi i vetë urës mesjetare të Vojnoviqit pasi që zona përreth saj ishte përdorur për një kohë të gjatë si deponi publike e mbeturinave, zonë parkimi dhe zonë tregu.

²³ Në komunën e Gjilanit/Gnjilane.

²⁴ MKRS-ja ka nënshkruar vendimin dhe e ka dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zyrat rajonale të Institutit, tek kryetarët, drejtorët e urbanizmit dhe departamentet e ndërtimit në të gjitha komunat e Kosovës.

²⁵ Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane.

2010, është thyer një dritare e Kishës së Shën-Eliasit në Vushtrri/Vuçitrn²⁶, si dhe janë vizatuar disa grafitë në mure. Përfundimisht, kryerësit janë zbuluar. Siguria e të dy kishave monitorohet nga policia e Kosovës. Në nëntor të vitit 2009, grafitet me shkurtesën AKSH²⁷ u gjetën në murin e Manastirit të Zoçishtës.²⁸ Në mars të vitit 2010, disa të panjohur kishin përdhosur kishën në Gornji Strmac/Sternac të Epërm.²⁹ Në prill të vitit 2010, Policia e Kosovës arriti të kthente në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, kambanën e vjedhur të Kishës “Sveto Vrace” në fshatin Novake/Novak³⁰, edhe pse ajo ishte thyer në copa dhe nuk mund të përdorej më. Vijimisht, më 20 maj 2010, gjykata komunale në Prizren dënoi tre kryerës shqiptarë me katër muaj burgim. Megjithatë, në një incident tjetër në Podujevë/Podujevo, individët që kanë ngjyrosur muret e Kishës “Shën Andreu” me vaj motorik më 27 qershor mbeten të paidentifikuar. Një prej incidenteve më të këqija gjatë periudhës së raportimit ka ndodhur më 18 shkurt 2010, në Gjilan/Gnjilane, ku për herë të parë pas vitit 1999, një grua e moshuar serbe ishte varrosur në varrezat ortodokse serbe të qytetit. Mëngjesin e nesërm, varri ishte gjetur i përdhosur, arkivoli ishte nxjerrë dhe ishte dëmtuar shumë. Me kërkesë të familjes, trupi u zhvarros dhe u transferua në një varrezë ortodokse serbe në fshatin e afërt të Koretište/Koretishtës. Incidente tjera, kryesisht përdhosje dhe vandalizëm i varrezave, kanë ndodhur në tërë Kosovën.³¹

3. ARSIMI

Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë, Rekomandimi nr. 19: Të konsiderohen mënyrat për krijimin e mundësive për ndërveprim mes nxënësve nga komuniteti serb dhe ai shqiptar, si dhe të disenjohet një plan gjithëpërfshirës që do të hiqte, me kohë, pengesat e ndryshme, duke përfshirë ato gjuhësore, mes nxënësve të komuniteteve të ndryshme.

Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë, Rekomandimi nr. 20: Të trajtohen brengat e personave që i përkasin komuniteteve pakicë dhe të vendosen masa që do të mund të zvogëlonin kërkesën për mbajtjen e sistemit paralel arsimor.

Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë, Rekomandimi nr. 23: Të sigurohen hapa vendimtarë për trajtimin e nevojave arsimore të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, duke përfshirë sigurimin e qëndrueshmërisë së programeve të hartuara për të ndihmuar nxënësit nga këto komunitete që të integrohen dhe të qëndrojnë brenda sistemit arsimor.

Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë, Rekomandimi nr. 24: Të mundësohet fleksibiliteti i zbatimit të reformave arsimore në lidhje me ata nxënës nga komuniteti goran, të cilët ende nuk janë integruar në sistemin e ri arsimor.

Gjetjet e raportit të vitit 2009

Ekzistenca e dy sistemeve të ndara arsimore, atij sipas kurrikulës së Kosovës dhe atij sipas kurrikulës së Serbisë, pengon integrimin dhe ndërveprimin mes nxënësve dhe

²⁶ Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica.

²⁷ Një grup që e quan veten “Armata Kombëtare Shqiptare” ka marrë përgjegjësinë për një numër të sulmeve me bomba në Kosovë dhe IRJ të Maqedonisë prej vitit 2003. Në komunikatat e tij, grupi avokon për bashkimin e të gjitha territoreve të banuara me shqiptarë.

²⁸ Në qytetin e Rahovecit/Orahovac, Rajoni i Prizrenit.

²⁹ Në komunën e Zubin Potokut, Rajoni Mitrovicë/Mitrovica.

³⁰ Në rajonin e Prizrenit.

³¹ Në gusht të vitit 2009, janë atakuar dy herë varrezat në Binçës/Binaç (Viti/Vitina), si dhe në Talinoc të Muhaxherëve/Muhadžer Talinovac (Ferizaj/Uroševac); në shtator 2009, në fshatin Vrellë/Vrelo (Lipjan/Lipljan); në tetor, në fshatin Mushtisht/Mušutište (Suharekë/Suva Reka); në nëntor 2009, në Videjë/Vidanje (Klinë/Klina) dhe Gornja Brnjica/Bërnice të Epërme (Prishtinë/Priština). Në janar 2010, dy varreza ortodokse ishin vandalizuar në fshatin Llapnasellë/Laplje Selo (Gračanica/Gračanicë), si dhe në fshatin Lismir/Dobri Dub (Fushë Kosovë/Kosovo Polje), ku i njëjti gur varri është dëmtuar dy herë; në mars në fshatin Rubovc/Rubovce (komuna Lipjan/Lipljan), është dëmtuar një varrezë tjetër. Në korrik të vitit 2010, varreza katolike e kroatëve në fshatin Šašare/Shasar (komuna Viti/Vitina) është përdhosur, derisa dritaret e kapellës ishin thyer. Kryqet e mermerit dhe fotografitë ishin dëmtuar në disa varre, supozohet brenda të njëjtit incident. Disa gurë varri ishin shkatërruar plotësisht, derisa në disa të tjerë dukeshin jashtëqitjet e kafshëve.

mësuesve të komuniteteve të ndryshme. Mungesa e mundësive të mësimi në të dyja gjuhët zyrtare sipas kurrikulës së Kosovës është një pengesë tjetër në raportet mes komuniteteve. Ka ende mangësi në hartimin e kurrikulave në gjuhët e komuniteteve joshqiptare, në ofrimin e teksteve cilësore shkollore, si dhe mungesë të mundësive për trajnim universitar të mësimdhënësve të komuniteteve. Integrimi i dobët brenda sistemit arsimor të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian paraqet shqetësim shtesë. Mungesa e një marrëveshjeje politike për të siguruar që nxënësit goranë në Dragash/Dragaš të kthehen në lokalet e përbashkëta shkollore me disa kurrikula, si dhe të gëzojnë arsim adekuat në gjuhën zyrtare të zgjedhur, ndikon në të drejtën e tyre për t'u arsimuar. Përveç kësaj, mospajtimi mes përgjegjësve të Kosovës dhe të Serbisë për kurrikula që solli te ndarja fizike mes dy grupeve të studentëve e pengoi edhe më shumë komunikimin mes nxënësve goranë dhe nxënësve të komuniteteve tjera.

Gjendja në terren

Edhe në ato shkolla ku sipas kurrikulës së Kosovës dhe asaj të Serbisë mësohet nën të njëjtin kulm, niveli i ndërveprimeve mes nxënësve dhe mësimdhënësve të komunitetit shqiptar të Kosovës dhe serb të Kosovës nuk është përmirësuar. Megjithatë, shihen raporte më të mira mes nxënësve në shkolla ku shkojnë komunitetet tjera joshumicë. Në dy shkolla fillore në Gjilan/Gnjilane dhe Dobërçan/Dobrčane, ku arsimi ofrohet në gjuhën turke, nxënësit turq të Kosovës ndërveprojnë me shqiptarët e Kosovës, edhe pse nuk janë në klasa të njëjta, por ndajnë vetëm hapësirën shkollore dhe oborrin. Nxënësit shqiptarë, boshnjakë, turq, romë, ashkali dhe egjiptianë ndërveprojnë me njëri-tjetrin në shkollat me kurrikulë të Kosovës në gjithë Kosovën.³² Ngjashëm, janë të dukshme marrëdhëniet e mira mes nxënësve serbë, boshnjakë, kroatë, malazezë, romë dhe ashkali të cilët vijojnë mësimin sipas kurrikulës së Serbisë.³³

Mundësitë për t'i mësuar gjuhët zyrtare ekzistojnë në disa komuna, ku turqit dhe boshnjakët e Kosovës kanë mundësi qasjeje në arsim në gjuhën e tyre amtare dhe gjithashtu u ofrohet mësim i njëjës nga dy gjuhët zyrtare. Në Pejë/Peć, për shembull, boshnjakët ndjekin mësim të gjuhës shqipe dy orë në javë, derisa arsimi në gjuhën turke ofrohet në një numër komunash.³⁴ Në qershor të vitit 2010, Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MASHT) miratoi një kurrikulë në gjuhën rome. Gramatika, kultura dhe historia priten të bëhen lëndë opsionale prej klasës së dytë deri në të nëntën për gjithë nxënësit që regjistrohen në sistemin arsimor të Kosovës.³⁵

Në fillim të këtij viti shkollor, MASHT-i kishte shpërndarë libra shkollore për gjitha lëndët për nxënësit e regjistruar në shkolla fillore, si dhe të cilët vijojnë mësimet në planprogramin e Kosovës, në gjuhën shqipe. Fëmijët shqiptarë të Kosovës në komunat

³² Në komunat: Prizren, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Prishtinë/Priština, Lipjan/Lipljan, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić, Shtime/Štimlje, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, jug të Mitrovicës/Mitrovica, Deçan/Dečane, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina, dhe Pejë/Peć.

³³ Në komunat: Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Vushtrri/Vučitrn, veri të Mitrovicës/Mitrovicë, Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zveçan, Dragash/Dragaš, Rahovec/Orahovac, Gračanica/Gračanicë.

³⁴ Arsimi në gjuhën turke ofrohet në komunat: Gjilan/Gnjilane, Vushtrri/Vučitrn, Mitrovicë/Mitrovica, Prizren, Mamuša/Mamushë/Mamuša, dhe Prishtinë/Priština. Në Janjevë/Janjevo, Komuna Lipjan/Lipljan, KFOR turk ofron mësim të gjuhës turke për nxënësit e shkollës fillore, dy herë në javë.

³⁵ Prej vitit akademik 2010-2011, Ministria e Arsimit ka për qëllim të nisë kurrikulën në gjuhën rome për klasën e dytë, dhe gradualisht edhe për klasat tjera, në vitet në vijim.

me shumicë serbe të Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zvečan/Zveçanit, gjithashtu kanë marrë librat pa pagesë. Ministria e Arsimit e Serbisë ofron libra shkollorë pa pagesë për nxënësit që ndjekin kurrikulën e Serbisë vetëm për klasën e parë, derisa nxënësit e klasave tjera duhet t'i blejnë vetë librat e tyre. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica një numër organizatash ndërkombëtare kanë kërkuar të lehtësojë këtë mungesë të librave shkollorë. Për shembull, Këshilli Danez për Refugjatë (DRC) ka siguruar libra shkollorë në gjitha lëndët për vajzat e komuniteteve romë dhe ashkali të klasës së dytë dhe të tretë, derisa OSBE-ja ka siguruar librat për gjitha lëndët nga klasa e katërt deri në klasën e tetë për të njëjtin grup të përfituesve. Fondi i OKB-së për Fëmijë (UNICEF) ka siguruar librat shkollorë për gjitha lëndët, prej klasës së dytë deri në të nëntën, të shkollës fillore, për nxënësit serbë.

Sa i përket mundësive për trajnim universitar për mësimitdhënësit e komuniteteve joshqiptare, MASHT-i ka organizuar një numër të vogël aktiviteteve. Në rajonin e Prizrenit, në bashkëpunim me OJQ-në “Qendra për Edukimin e Mësimdhënësve”, MASHT-i ka ofruar trajnime për “Zhvillimin psiko-social të fëmijëve” për mësimitdhënësit boshnjakë dhe turq të Kosovës. Sa i përket komunitetit goran dhe atij serb të Kosovës, nuk ka kontakte zyrtare mes komunave dhe mësimitdhënësve të sistemit sipas kurrikulës së Serbisë. Në mars të vitit 2010, OSBE-ja, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare Qendra për Arsim e Kosovës, e implementoi një projekt që kishte për qëllim t’u ofrojë ndihmë mësimitdhënësve e historisë për t’i shfrytëzuar metodat dhe materialet e mësimitdhënies pjesëmarrëse dhe me shumë perspektiva në orët e lëndës së tyre.

Në lidhje me implementimin e “Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë”, aktivitetet e ndërmarra në fushën e arsimit kryesisht i referohen fushatave të vetëdijesimit për rëndësinë e edukimit, të cilat synojnë prindërit dhe përfshijnë drejtoritë komunale të arsimit dhe zyrat komunale të komuniteteve. Në Klinë/Klina dhe Istog/Istok, drejtorët e shkollave dhe mësuesit themeluan komitete me qëllim të trajtimit të fëmijëve që braktisin shkollën. Si rezultat, fëmijët e dy familjeve ashkali dhe shtatë familjeve egjiptiane u kthyen në shkollë. Vetëm Komuna e Ferizajt/Uroševac ka organizuar orë plotësuese për fëmijët që kishin braktisur shkollën, ose ishin zhvendosur apo të riatdhesuar me forcë. Në disa komuna tjera, këto aktivitete mbulohen nga organizata lokale apo ndërkombëtare pa ndonjë angazhim apo mbështetje serioze nga institucionet komunale. Në Ferizaj/Uroševac, Qendra e Komunitetit Ashkali organizon orë plotësuese për 37 fëmijë, derisa Caritas Kosova, UNICEF-i dhe organizata lokale PADEM ofrojnë mbështetje në fushën e edukimit për fëmijët romë dhe ashkali që banojnë në kampet në veri të Mitrovicës/Mitrovica dhe në Leposavić/Leposaviq. Organizata jo-qeveritare Balkan Sunflowers, përmes qendrave të saj mësimore³⁶, promovon arsimin te nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë.

Nxënësit goranë në Dragash/Dragaš që vijnë në mësimet në sistemin arsimor të Serbisë kanë arritur ta përfundojnë vitin akademik në paralele të ndara shtatë kilometra larg nga Dragashi/Dragaš.³⁷ Në fillim të vitit shkollor 2009/2010, pati një periudhë tri-

³⁶ Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić, Shtime/Štimlje dhe Gračanica/Gračanicë.

³⁷ Kurrikula e Kosovës dhe ajo e Serbisë ekzistojnë në të njëjtat hapësira për disa vite me radhë. Pas refuzimit të mësimitdhënësve goranë që të nënshkruajnë kontratat e tyre me MASHT-in në vend se të ishin punëtorë të Ministrisë serbe të Arsimit, në shtator 2008, komuna ua ndaloi mësimitdhënësve goranë hyrjen në shkollën fillore të menaxhuar nga komuna në Dragash/Dragaš. Si rezultat, nga

javore që autobusi i financuar nga institucionet serbe nuk kishte dokumentacionin e duhur për operim në komunën e Dragashit/Dragaš. Kështu, e drejta e këtyre nxënësve për arsim u dëmtua edhe njëherë, duke qenë të detyruar të kalojnë distanca të largëta në këmbë për të vijuar mësimet.

Çështjet e mbetura

Me përjashtim të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica, të gjitha rajonet tjera kanë disa shkolla në të cilat sistemet arsimore të Kosovës dhe Serbisë ekzistojnë nën të njëjtin kulm. Megjithatë, nxënësit shqiptarë dhe serbë të Kosovës ndërveprojnë shumë rrallë. Zakonisht, orët mbahen në dy ndërrime të ndara, derisa komunikimi mes tyre mbahet në minimum.³⁸ Në komunën e Gjilanit/Gnjilane³⁹ ka një periudhë 45-minutëshe mes dy ndërrimeve, derisa në komunën e Novo Brdo/Novobërdës⁴⁰ pauza mes dy ndërrimeve është mes 30 dhe 60 minutash. Kështu, nxënësit e dy komuniteteve nuk takohen fare. Në fshatrat e përzier të Mogillës/Mogila⁴¹ dhe Binçës/Binaç⁴², nxënësit nga dy komunitetet ndjekin mësimet në të njëjtën ndërtesë, në të njëjtën kohë. Megjithatë, nuk ka aktivitete të organizuara për të rritur ndërveprimin mes nxënësve dhe mësimdhënësve të komuniteteve të ndryshme.

Pengesa kryesore për integrimin e vërtetë, mbetet mungesa e mundësisë që të vijohet mësimi në të dyja gjuhët zyrtare, pasi nuk ka as shkolla, as organe tjera që ofrojnë arsim edhe në gjuhën shqipe edhe atë serbe. Efekti i menjëhershëm është që distanca mes shqipfolësve dhe serbfolësve mbetet e konsiderueshme, derisa efekti afatgjatë është që gjeneratat e reja nuk do të jenë në gjendje të komunikojnë me njëra-tjetrën.

Kanë mbetur probleme edhe në lidhje me librat shkollorë të detyrueshëm në gjuhën turke dhe boshnjake. Fëmijët boshnjakë që vijnë në mësimet në sistemin arsimor kosovar në gjuhën boshnjake në komunën e Prishtinës/Priština nuk kanë marrë librat pa pagesë nga MASHT-i. Gjithsej, 17 nga 69 libra në gjuhën boshnjake, si dhe 16 nga 70 librat në gjuhën turke nuk janë në dispozicion në Kosovë. Numri i librave shkollorë në dispozicion për arsimin e mesëm është edhe më i vogël.⁴³ Kështu, boshnjakët dhe turqit në Kosovë duhet të blejnë libra shtesë në Turqi dhe Bosnjë e Hercegovinë. Librat shkollorë të siguruar nga MASHT-i në gjuhën turke dhe boshnjake janë të cilësisë së ulët. Kjo ndodh për shkak të faktit që shpesh ata që janë në krye të hartimit dhe përkthimit të librave në gjuhën boshnjake apo turke nuk e kanë

shtatori deri në dhjetor, 135 nxënës goranë nuk kishin mundësi të qasjes në lokalet shkollore dhe arsim në gjuhën serbe, derisa në janar të vitit 2009, nxënësit dhe mësimdhënësit goranë lëvizën drejt paraleleve të ndara në fshatrat fqinje. Disa nga pasojat ndërlidhen me problemet e transportimit, sidomos gjatë periudhës së dimrit, si dhe cilësinë e arsimit. Edhe pse Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare dhe vetë Misioni i OSBE-së në Kosovë kishin ndërmjetësuar për ta gjetur një marrëveshje, ende nuk është gjetur ndonjë zgjidhje e qëndrueshme.

³⁸ Në shkolla në Brod/Brod, Komuna Dragash/Dragaš; Caravodice/Crkvena Vodica në komunën Obiliq/Obilić; Rubovc/Rabovce në Lipjan/Lipljan; si dhe Sigë/Siga në komunë e Pejës/Peć.

³⁹ Në fshatin e përzier të Poneshit/Poneš, shqiptarët dhe serbët e shfrytëzojnë të njëjtën shkollë, njëkohësisht. Për nxënësit serbë, shkolla është paralele e shkollës fillore të Parallovës/Paralovo e cila funksionon nën sistemin e Serbisë.

⁴⁰ Në fshatin e përzier të Jasenovikut/Jasenovik, shqiptarët dhe serbët bashkërisht e shfrytëzojnë shkollën, e cila është në qendrën gjeografike të fshatit.

⁴¹ Komuna e Klokot/Kllokotit.

⁴² Komuna e Vitisë/Vitina.

⁴³ Për shembull, vetëm një libër shkollor për nxënësit e shkollës së mesme të lartë, gjegjësisht Libri i Leximit për klasën e 8-të, është në dispozicion në gjuhën boshnjake.

atë gjuhë amtare. Kështu, përkthimet shpesh kanë qenë të standardit të ulët si në aspekt gjuhësor, ashtu edhe të përmbajtjes.

Më 2 korrik 2010, MASHT-i shpalli një tender tremujor për hartimin e librave shkollorë në gjuhën rome dhe, si rrjedhim, ato nuk ishin në dispozicion në fillim të vitit shkollor. Ekzistonte një numër i pamjaftueshëm i mësuesve të trajnuar, derisa familjet nuk kanë marrë informata të mjaftueshme për të vendosur nëse duan t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në kurrikulën rome. Duhet ndërmarrë përpjekje konkrete dhe më sistematike për të zbatuar komponentin edukativ të "Strategjisë për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian".

Përfundimisht, përkundër intervenimeve të Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë për të zgjidhur këtë çështje që ka ekzistuar për një kohë të gjatë, nxënësit goranë ende u nënshtrohen ende ndërhyrjeve politike që ndikojnë në mundësitë e tyre për të gëzuar plotësisht të drejtën e tyre për arsim, dhe vazhdojnë të vuajnë nga mungesa e një kurrikule formale në gjuhën e tyre amtare.

4. PËRDORIMI I GJUHËVE

Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë, Rekomandimi nr. 16: Të miratohet legjislacioni i ri për gjuhët për të ngritur qartësinë dhe sigurinë ligjore në lidhje me përdorimin e gjuhëve, duke përfshirë dispozitat në lidhje me autoritetet administrative, shenjat topografike, si dhe regjistrimin e emrave personal, si dhe të monitorohet për së afërmi zbatimin e kërkesave gjuhësore në sektorët gjegjës, duke përfshirë atë gjyqësor.

Gjetjet e raportit të vitit 2009

Edhe pse korniza ligjore zbaton kërkesat ndërkombëtare në lidhje me të drejtat gjuhësore, implementimi i saj mbetet joadekuat. Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare rrezikon qasjen ndaj shërbimeve publike shumëgjuhëshe, si dhe atë të pjesëmarrjes efektive në jetën publike. Ngjashëm, kjo gjendje pengon Komisionin e Gjuhëve⁴⁴ nga të qenit mekanizëm efektiv i hartimit të politikave.

Gjendja në terren

Komunitetet joshumicë në Kosovë në përgjithësi e ndjejnë vetën të lirë të përdorin gjuhët e tyre në vende publike, si dhe i drejtohen zyrtarëve komunalë në gjuhët zyrtare në pjesën më të madhe të Kosovës. Disa komuna ofrojnë përkthim verbal në takime komunale dhe përkthim tekstual në gjuhët zyrtare. Në komunat ku gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare⁴⁵, shumica e dokumenteve zyrtare është në dispozicion në gjuhën e tyre amtare, derisa përkthimi në gjuhën boshnjake ofrohet edhe gjatë takimeve zyrtare të kuvendit komunal. Ende janë në vazhdim diskutimet në komunën e Prizrenit për mundësinë e miratimit të gjuhës rome si gjuhë në përdorim zyrtar, pasi që është gjuhë që tradicionalisht është folur në komunë. Edhe pse komuniteti nuk ka parashtruar kërkesë zyrtare, zyrtarët komunalë kanë diskutuar këtë çështje në disa raste.

⁴⁴ Komisioni i Gjuhëve është themeluar në vitin 2007, brenda Zyrës së Kryeministrit, si institucion i pavarur me mandat të ruajtjes, promovimit, mbrojtjes dhe monitorimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe për të siguruar statusin e tyre të barabartë në Kosovë. Ai gjithashtu siguron mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, por është në përdorim zyrtar në komuna të caktuara.

⁴⁵ Në Pejë/Peć, Prizren dhe Dragash/Dragaš.

Një trend i njëjtë në tërë Kosovën është se njësitë komunale për përkthim, në ato komuna ku ato janë krijuar,⁴⁶ kanë përgjithësisht personel të pamjaftueshëm për shkak të kufizimeve financiare. Përveç kësaj, përkthyesit komunalë përgjithësisht nuk kanë shkathtësi profesionale për përkthimin e dokumenteve ligjore dhe për këtë arsye përkthimet janë shpeshherë të pasakta. Për më tepër, mungesa e burimeve ndikon në disponueshmërinë e materialeve të domosdoshme, siç janë fjalorët, dhe në të njëjtën kohë nuk lejon kontraktimin e shërbimeve të përkthimit për rastet urgjente. Siç raportohet, disa nga komunat e banuara me shqiptarë të Kosovës⁴⁷ e konsiderojnë obligimin e përkthimit të dokumenteve në gjuhët zyrtare si një ngarkesë të panevojshme financiare të imponuar nga institucionet e Kosovës.

Më 22 prill 2009, zëvendëskryesuesi për komunitete i Kuvendit Komunal të Prizrenit paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, në lidhje me shqetësimet e komunitetit turk dhe boshnjak të Kosovës për përmbajtjen dhe procedurat e miratimit të emblems së Komunës të Prizrenit. Komunitetet ishin ankuar për faktin që emblema e komunës “1878 Prizren”, që i referohet Lidhjes së Prizrenit⁴⁸, nuk pasqyron parimet e bashkëjetesës, shumetnisë, shumgjuhësisë dhe multikulturalizmit. Një shqetësim tjetër ishte edhe fakti se emblema nuk përfshinte shprehjen “komunë” në të gjitha gjuhët zyrtare të Prizrenit. Më 18 mars 2010, Gjykata Kushtetuese vlerësoi që emblema kishte shkelur të drejtat e komuniteteve joshumicë sa i përket mbrojtjes dhe respektimit të identitetit të tyre dhe udhëzoi komunën e Prizrenit që të ndërrojë emblemen brenda tri muajve.⁴⁹ Megjithatë më 16 qershor 2010, përkatësisht dy ditë para skadimit të afatit, Gjykata Kushtetuese iu përgjigj pozitivisht kërkesës së komunës për vazhdimin e afatit edhe për një periudhë shtesë prej 90 ditëve për zbatimin e vendimit në fjalë.⁵⁰ Më pas, emblema e komunës mbetet e pandryshuar.

Çështjet e mbetura

Edhe pse situata në Kosovë është përmirësuar deri në një masë sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare, ende mbesin disa sfida që duhet të adresohen në mënyrë që të respektohet legjislacioni përkatës.

Në nivel qendror, Komisioni i Gjuhëve mbetet joefikas dhe i panjohur për shumicën e njerëzve në Kosovë. Gjatë vitit të kaluar, Komisioni i Gjuhëve nuk kishte marrë asnjë ankesë pasi që qytetarët janë përgjithësisht të painformuar për ekzistimin e këtij komisioni dhe për procedurat dhe mekanizmat e ankimit. Për më shumë, Qeveria e Kosovës nuk kishte ndërmarrë asnjë fushatë informimi për sqarimin e obligimeve të institucioneve qendrore dhe atyre komunale, dhe për të drejtat e përdoruesve të

⁴⁶ Komunat Junik/Junik, Malishevë/Mališevo, Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zveçan, Zubin Potok, Gillogoc/Glogovac, Obiliq/Obilić dhe Shtime/Štimlje nuk kanë njësi përkthimi.

⁴⁷ Për shembull, në komunat Malishevë/Mališevo dhe Suharekë/Suva Reka nga ku serbët u detyruan të largohen në vitin 1999, dhe ku deri më sot nuk ka pasur asnjë kthim.

⁴⁸ Lidhja e Prizrenit është një organizatë politike shqiptare, që ishte themeluar më 10 qershor 1878 në Prizren.

⁴⁹ Gjykata Kushtetuese, Rasti Nr. KO 01/09, “Qemajl Kurtishi/Ćemailj Kurtiši dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit”, 21 qershor 2010.

⁵⁰ Më 18 qershor 2010, Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi që të vazhdojë afatin kohor për Komunën e Prizrenit në lidhje me zbatimin e vendimit të gjykatës deri më 18 shtator 2010, dhe kërkoi nga Komuna që të raportojë për përparimin e arritur sa i përket zbatimit të vendimit të gjykatës para skadimit të afatit.

gjuhëve zyrtare dhe të komuniteteve.⁵¹ Një ndër pengesat kryesore për funksionimin e duhur të këtij organi është mungesa e burimeve. Gjithashtu, fakti që anëtarët e komisionit mbajnë funksione tjera në ministri të ndryshme dhe që nuk paguhen për punën e tyre në Komision kishte rezultuar në mungesën e angazhimit. Përfundimisht, nuk ka përkrahje politike nga Qeveria e Kosovës, që ndonjëherë dështon të respektojë Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Për shembull, në muajin janar të vitit 2010 Zyra e Kryeministrit publikoi një raport për të drejtat e njeriut⁵² që nuk ishte në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve pasi që në raport janë përdorur vetëm emrat e komunave në gjuhën shqipe, si dhe referencat ndaj emrave jozyrtarë të qyteteve.

Edhe kompanitë publike nuk kishin respektuar dispozitat e ligjit për gjuhët. Në muajin shkurt të vitit 2010, Korporata Energjetike e Kosovës shkyçi disa fshatra dhe vendbanime të banuara me komunitete joshumicë ndërsa i kishte lëshuar vërejtjet për shkyçje vetëm në gjuhën shqipe.⁵³ Po ashtu, banorët serbë të Kosovës në komunën e Obiliqit/Obilić, rajoni i Prishtinës/Priština, pohojnë të kenë pranuar vetëm fatura në gjuhën shqipe me emrin jozyrtar të Komunës “Kastriot”, një shprehje që zakonisht përdoret nga komuniteti shqiptar i Kosovës.

Në nivel komunal, serbët dhe shqiptarët e Kosovës ende ballafaqohen me vështirësi për të folur publikisht gjuhët e tyre përkatëse në ato vende ku ata përbëjnë komunitetin joshumicë.⁵⁴ Në komunën e Vitisë/Vitina, pjesëtarët e komunitetit kroat kanë një frikë të perceptuar për disa vende të caktuara publike ku komuniteti heziton të flasë haptazi gjuhën kroate. Pjesëtarët e komunitetit rom nuk ndihen të lirë për të përdorur gjuhën serbe në vendet e banuara kryesisht me shqiptarë të Kosovës, dhe në ato vende ku është e mundur ata komunikojnë në gjuhë shqipe.

Ka probleme në lidhje me ofrimin e përkthimit në gjuhët zyrtare gjatë takimeve nëpër komuna, sigurimin e dokumenteve zyrtare në të gjitha gjuhët zyrtare dhe cilësinë e përkthimit dhe drejtshqiptimin e saktë të emrave personalë dhe të tabelave topografike. Disa komuna dështojnë të sigurojnë përkthim gjatë mbledhjeve të kuvendeve komunale apo të komisioneve për komunitete.⁵⁵ Përveç kësaj, kur përkthimi sigurohet ai zakonisht është i vonshëm dhe i cilësisë së dobët. Në përgjithësi, komunat ua atribuojnë këto dështime përkthyesve të mbingarkuar me punë dhe mungesës së stafit. Pjesëtarët e komunitetit serb janë më të prekurit nga mungesa e përkthimit, pastaj janë turqit e Kosovës në komunat ku gjuha turke është gjuhë në përdorim zyrtar. Shqiptarët e Kosovës kanë vështirësi në komunën e porsaformuar të Graçanicës/Gračanica për shkak se komuna nuk ka njësi të përkthimit, ende nuk është

⁵¹ Shih Nenin 36(2), Ligji për Përdorimin e Gjuhëve nr. 02/L-37, siç është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/51, 20 tetor 2006.

⁵² Zyra e Kryeministrit, “Raport për aktivitetet në fushat e të Drejtave të Njeriut, Mundësive të Barabarta, të Drejtave të Minoriteteve, të Drejtave të Fëmijës, të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, Kundër-Diskriminimit dhe Kundër-Korrupsionit”, janar 2010.

⁵³ Vërejtjet për shkyçje në gjuhën shqipe u ishin shpërndarë Manastirit të Deviçit në komunën e Skenderajt/Srbica, Grace/Gracës në Vushtrri/Vučitrn, Brestovik/Brestovik në Pejë/Peć dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje në Prishtinë/Priština.

⁵⁴ Serbët e Kosovës nuk ndihen rehat për t’u shprehur në gjuhën e tyre amtare për shkak të shqetësimeve të sigurisë në disa komuna, si në Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Gllogoc/Glogovac dhe Skenderaj/Srbica. Shqiptarët e Kosovës nuk përdorin gjuhën e tyre amtare publikisht në komunat veriore Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan.

⁵⁵ Në Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Deçan/Dečane, Malishevë/Mališevo, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Graçanica/Gračanicë, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo dhe Prishtinë/Priština.

përpiluar rregullorja komunale për përdorimin e gjuhëve dhe transkriptimet e mbledhjeve të kuvendit komunal sigurohen vetëm në alfabetin cirilik serb. Megjithatë në muajin mars të vitit 2010, komuna kishte punësuar një përkthyes shqiptar të Kosovës dhe kjo disi ka zbutur situatën. Në komunën e Pejës/Peć, mësimdhënësit boshnjak të Kosovës kishin marr kontratat e tyre vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa në muajin korrik të vitit 2010 ata parashtruan një ankesë në komisionin për komunitete.⁵⁶

Disa çështje po ashtu janë paraqitur në lidhje me drejtshqiptimin e të dhënave personale në dokumentet zyrtare dhe personale, si dhe në lidhje me emrat e fshatrave në tabelat topografike. Mosrespektimi ka qenë më se i dukshëm për gjuhët turke dhe serbe, për shkak se gjoja komunat nuk kanë programe teknike të softuerit për këto gjuhë. Prandaj disa shkronja nga alfabeti turk dhe atë serb kopjohen gabimisht në gjuhën shqipe dhe kështu shtypen gabimisht në letërnjoftime, certifikata të lindjes, tituj të pronës dhe në çfarëdo dokumenti tjetër zyrtar. Në dokumentet e Kosovës, emrat në gjuhën serbe në përgjithësi mbishkruhen në alfabetin latin në vend të atij cirilik, që është dorëshkrimi zyrtar i gjuhës serbe. Në mënyrë të ngjashme, tabelat topografike përmbajnë gabime të ndryshme si në Vushtrri/Vučitrn, ku tabelat në rrugën kryesore kanë katër versione të ndryshme të gjuhës serbe, ose nuk i përmbahen rregullave për shkak se nuk përmbajnë të gjitha gjuhët zyrtare. Për shembull, në Skenderaj/Srbica në tabelat e reja shkruhet “Skenderaj/Skenderaj”, dhe në Mamuša/Mamushë/Mamuša tabelat janë vetëm në gjuhën shqipe dhe turke. Shpeshherë, tabelat në gjuhët zyrtare fshihen ndërsa në disa fshatra ku jetojnë komunitetet joshumicë nuk ka asnjë tabelë.⁵⁷

5. PJESËMARRJA

Rekomandimi nr. 26 i Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë: vazhdon përpjekjet për të siguruar pjesëmarrjen e përmirësuar të personave nga radhët e komuniteteve pakicë në strukturat dhe proceset e IPVQ-ve.

Rekomandimi nr. 28 i Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë: shqyrtoni mënyrat për të përmirësuar përfaqësimin dhe efikasitetin e komisioneve për komunitete në komuna.

Të gjeturat e raportit të vitit 2009

Pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve në shërbimin civil të nivelit qendror dhe komunal dhe në procesin e vendimmarrjes mbetet një sfidë. Numri i nismave me qëllim të garantimit të zbatimit të “Strategjisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian” është i pamjaftueshëm.

Situata në terren

Ligji i zbatueshëm për Shërbimin Civil parashikon përfaqësim minimal prej 10 për qind të komuniteteve joshqiptare në nivel qendror dhe përfaqësim proporcional bazuar në numrin e pjesëtarëve që u takojnë komuniteteve joshumicë në nivel komunal.⁵⁸ Sipas statistikave zyrtare, shkalla e përfaqësimit të komuniteteve joshqiptare në

⁵⁶ Deri në përpilimin e këtij raporti, mësimdhënësit boshnjak të Kosovës nuk kanë marrë ndonjë përgjigje zyrtare.

⁵⁷ Për shembull, ky është rasti me fshatin Prelluzhë/Priluzje në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, që është i banuar nga pjesëtarët e komunitetit serb dhe rom të Kosovës.

⁵⁸ Shih Nenin 11, Ligji për Shërbimin Civil, Nr. 03/L–149, 14 qershor 2010. Pas miratimit të kriterëve të ndryshme të përfshira në këtë ligj, përfaqësimi i komuniteteve joshumicë u zvogëluar prej 16.6 për qind në 10 për qind.

Kuvendin e Kosovës është 12.93 përqind, në Zyrën e Kryetarit është 10.35 për qind dhe në Qeveri është 7.89.⁵⁹

Në mungesë të regjistrimit të popullsisë, nuk mund të sigurohen të dhëna të sakta për përfaqësimin proporcional të komuniteteve joshumicë në shërbimin civil komunal. Megjithatë, janë në dispozicion të dhënat për pjesëmarrjen e komuniteteve joshumicë në nivel komunal. Prej 1,034 anëtarë të kuvendeve komunale, 53 janë përfaqësues të komuniteteve joshumicë ndërsa 13 janë femra.⁶⁰ Komuniteti më i përfaqësuar joshumicë janë shqiptarët e Kosovës, në ato vende ku ata përbëjnë komunitetin joshumicë me 27 anëtarë të kuvendeve komunale,⁶¹ ndjekur nga boshnjakët e Kosovës që kanë nëntë anëtarë të kuvendeve komunale,⁶² turqit e Kosovës kanë shtatë⁶³, komuniteti egjiptian ka katër anëtarë,⁶⁴ ashkallitë kanë tre,⁶⁵ goranët kanë dy,⁶⁶ dhe malazezët⁶⁷ dhe romët⁶⁸ kanë nga një anëtar të kuvendeve komunale. Pjesëtarët e komunitetit serb dhe kroat nuk kanë përfaqësues në komunat ku ata përbëjnë komunitete joshumicë. Përveç kësaj, procesi i decentralizimit dhe si pasojë themelimi i katër komunave të reja, të banuara kryesisht me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, ka ulur numrin e pjesëtarëve të komunitetit serb në ato komuna ku kanë banuar më herët. Si pasojë, përfaqësimi i tyre në kuvendet komunale amë është zvogëluar.⁶⁹

Sa i përket mekanizmave të pjesëmarrjes në nivel komunal, njëmbëdhjetë komuna⁷⁰ kanë emëruar nënkryetarët për komunitete. Pesë shqiptarë, dy serbë, dy turq, një boshnjak dhe një egjiptian e mbajnë këtë post. Ligji përcakton pragun prej dhjetë për qind⁷¹ për krijimin e kësaj pozite. Megjithatë, katër komuna⁷² kishin vendosur të

⁵⁹ Zyra e Kryeministrit, Raporti “Punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në Ndërmarrjet në Pronësi Publike”, mars 2010, f. 36 - 37.

⁶⁰ Të dhënat e siguruar nuk përfshijnë shifrat nga komunat e porsaformuara të Parteshit/Parteš dhe Junikut/Junik.

⁶¹ Është një anëtar shqiptar i Kosovës në kuvendin komunal të Mamuša/Mamushës/Mamuša, një në Gračanica/Gračanicë, pesë në Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc, dhjetë në Novo Brdo/Novobërdë dhe dhjetë Štrpce/Shtërpçë.

⁶² Pjesëtarët e komunitetit boshnjak kanë tri përfaqësues në kuvendin komunal të Prizrenit, Dragashit/Dragaš dhe Pejës/Peć.

⁶³ Pjesëtarët e komunitetit turk kanë tre përfaqësues në Prizren dhe nga një në Gjilan/Gnjilane, Vuštrri/ Vuçitrn, Mitrovicë/Mitrovica dhe Prishtinë/Priština.

⁶⁴ Pjesëtarët e komunitetit egjiptian kanë nga një përfaqësues në kuvendin komunal të Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Pejës/Peć, Gjakovës/Đakovica dhe Istogut/Istok.

⁶⁵ Dy ashkali janë anëtarë të kuvendit komunal në Ferizaj/Uroševac dhe një është anëtar në kuvendin komunal të Fushë Kosovës/Kosovo Polje.

⁶⁶ Janë dy anëtarë nga komuniteti goran në kuvendin komunal të Dragashit/Dragaš.

⁶⁷ Një malazez i Kosovës është anëtar i kuvendit komunal të Fushë Kosovës/Kosovo Polje.

⁶⁸ Një pjesëtar i komunitetit romë është anëtar i kuvendit komunal në Prizren.

⁶⁹ Klokot/Kllokoti dhe Ranilug/Ranillugu, rajoni i Gjilanit/Gnjilane, dhe Gračanica/Gračanica, rajoni i Prishtinës/Priština, janë komunat e reja të themeluara pas zgjedhjeve të mbajtura në muajin nëntor të vitit 2009. Në muajin qershor të vitit 2010, zgjedhjet janë mbajtur edhe në komunën e porsaformuar të Parteš/Parteshit, në rajonin e Gjilanit/Gnjilane.

⁷⁰ Mitrovicë/Mitrovica, Gjilan/Gnjilane, Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc, Novo Brdo/Novobërdë, Ranilug/Ranillug, Štrpce/Shtërpçë, Obiliq/Obilić, Dragash/Dragaš, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Lipjan/Lipljan dhe Pejës/Peć. Komuna e Pejës/Peć ka emëruar dy nënkryetarë për komunitete, përkatësisht një serb dhe një egjiptian. Megjithatë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ nga Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, është shkarkuar nënkryetari serb për komunitete për shkak se pozita nuk mund të financohet nga buxheti komunal.

⁷¹ Shih Nenin 61, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, 15 qershor 2008.

⁷² Gjilan/Gnjilane, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica dhe Lipjan/Lipljan.

emërojnë nënkryetarin për komunitete edhe pse nuk e kishin obligim ligjor ta bëjnë një gjë të tillë, përderisa dy komuna tjera⁷³ nuk kanë përmbushur obligimet e tyre ligjore.

Trembëdhjetë komuna⁷⁴ kanë emëruar zëvendës-kryesuesit e kuvendit komunal dhe këtë pozitë e mbajnë tre përfaqësues të komunitetit shqiptar të Kosovës, turk të Kosovës dhe egjiptian, dy pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës dhe një pjesëtar i komunitetit boshnjak i Kosovës. Ashtu si edhe në rastin e nënkryetarit, edhe për këtë pozitë është përcaktuar pragu prej dhjetë për qind.⁷⁵ Disa komuna⁷⁶ kanë emëruar zëvendës-kryesuesin edhe pse nuk është përmbushur kushti i pragut ndërsa komuna e Obiliqit/Obilić nuk e ka respektuar këtë obligim ligjor.

Mekanizmat tjerë, siç janë komisioni për komunitete, zyrat komunale për komunitete dhe zyrtarët komunal për kthim, në përgjithësi janë themeluar dhe caktuar, dhe janë funksional në tërë Kosovën. Disa probleme vazhdojnë në lidhje me përfaqësimin e komuniteteve joshumicë, si ai me pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, që nuk përfaqësohen në disa komuna. Këshillat komunal për siguri në bashkësi janë themeluar në 26 komuna por sfida mbetet përfaqësimi i të gjitha komuniteteve në këto këshilla. Pjesëtarët e komunitetit romë janë më të prekurit për shkak se ata nuk përfaqësohen në disa këshilla komunal për siguri në bashkësi.⁷⁷ Përfundimisht, vetëm 18 komuna kanë themeluar grupet punuese komunale për kthim. Efikasiteti i tyre i përgjithshëm mbetet i diskutueshëm.

Në dhjetor të vitit 2009, Kuvendi i Kosovës e miratoi planin e veprimit për zbatimin e “Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian”. Më 26 maj 2010, Qeveria e Kosovës themeloi “Këshillin Drejtues Ndër-Institucional për Zbatimin e Planit të Veprimit” (Këshilli Drejtues) për mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë dhe ofrimit të përkrahjes dhe udhëzimeve politike. Për shkak të përbërjes së tij, pritet që Këshilli Drejtues të sigurojë bashkërendim ndërmjet ministrive përkatëse dhe do të sigurojë ndarjen e burimeve të mjaftueshme financiare nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.⁷⁸ Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë nga një përfaqësues në Këshillin Drejtues dhe ata përfaqësojnë interesat e komuniteteve të tyre. Mbledhja e parë e Këshillit Drejtues u mbajt më 8 korrik 2010.

Çështjet e mbetura

Niveli i ulët i punësimit të joshqiptarëve në shërbimin civil është shqetësues. Ligji për shërbimin civil zvogëlon nivelin minimal për pjesëmarrjen e komuniteteve joshqiptare

⁷³ Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Gračanica/Graçanicë.

⁷⁴ Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc, Novo Brdo/Novobërdë, Štrpce/Shtërpçë, Mitrovicë/Mitrovica, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Pejë/Peć, Gračanica/Graçanicë, Lipjan/Lipljan, Prishtinë/Priština dhe Dragash/Dragaš.

⁷⁵ Neni 54, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, 15 qershor 2008.

⁷⁶ Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Mitrovicë/Mitrovica, Prishtinë/Priština dhe Lipjan/Lipljan.

⁷⁷ Gjakovë/Đakovica, Deçan/Deçane, Vushtrri/Vučitrn, Prishtinë/Priština dhe Lipjan/Lipljan.

⁷⁸ Sipas planit të veprimit, Këshilli Drejtues kryesohet nga zëvendës-Kryeministri dhe përbëhet nga Ministri i Arsimit, Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministri i Shëndetësisë, Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë (që të njëjtën kohë është edhe zëvendës drejtor i këshillit), Drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, një anëtar nga këshilli konsultativ për komunitete dhe nga një përfaqësues i komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian.

në shërbimin civil nga 16.6 për qind në 10 për qind.⁷⁹ Në vend të inkurajimit të punësimit të pjesëtarëve nga të gjitha komunitetet, posaçërisht të atyre që nuk janë sa duhet të përfaqësuar, kriteri i përqindjes më të ulët zvogëlon mundësitë e komuniteteve joshqiptare për të marrë pjesë në jetën publike të Kosovës. Në nivelin komunal, përfaqësimi i pamjaftueshëm i komuniteteve joshqiptare në kuvendet komunal rrezikon mundësitë e tyre për t'u bërë pjesë aktive e shoqërisë kosovare dhe po ashtu për të mbrojtur dhe promovuar në mënyrë efikase të drejtat e tyre. Duhet të ketë më shumë përpjekje për të themeluar dhe për të siguruar të gjitha mekanizmat e paraparë të pjesëmarrjes, dhe për të siguruar një forum për të gjitha komunitetet, posaçërisht në ato komuna ku kushti ligjor prej 10 për qind është përmbushur.

Niveli i zbatimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian është ende i pamjaftueshëm. Qeveria e Kosovës miratoi planin e veprimit një vit pas miratimit të strategjisë⁸⁰, duke parandaluar kështu ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe nga buxhetet komunale. Janë dashur 5 muaj pas miratimit që të themelohet Këshilli Drejtues, me mandat zbatimin dhe sigurimin e mbështetjes financiare për aktivitetet e parapara me planin e veprimit. Ndarja e burimeve financiare për vitin 2001 mbetet e papërcaktuar.

6. KTHIMI DHE RIINTEGRIMI

Rekomandimi nr. 9 i Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë: Ndërmarrja e masave energjike për heqjen e pengesave për kthim të qëndrueshëm, duke trajtuar seriozisht shqetësimet e sigurisë të serbëve dhe të tjerëve dhe duke siguruar riposedimin dhe qasjen e papenguar në tokën bujqësore dhe në pasurinë tjetër, duke përfshirë edhe implementimin e legjisllacionit të miratuar rrishtazi, dhe duke paraparë edhe aktivitetet e tjera për gjenerimin e të ardhurave.

Rekomandimi nr. 11 i Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë: Të aplikohen masa të ofrimit të ndihmës dhe të bëhet shpërndarje më e qartë e përgjegjësiive institucionale për të siguruar integrim të vazhdueshëm të atyre personave nga grupet pakicë që janë kthyer me forcë në Kosovë.

Rekomandimi nr. 12 i Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë: Të ndërmerren masa të tjera urgjente për trajtimin e gjendjes alarmuese shëndetësore të romëve në kampet e kontaminuara me plumb në Kosovën veriore, duke konsideruar shëndetin e romëve si çështje primare, dhe të ndërmerren masa shtesë për të lehtësuar kthimin e romëve dhe për të parandaluar krizat e tilla shëndetësore në të ardhmen.

Të gjeturat e raportit të vitit 2009

Pengesat kryesore për kthimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm të refugjatëve dhe personave të zhvendosur vazhdojnë të jenë qasja e kufizuar apo e vonuar në kthimin e pronës, kushtet e papërshtatshme të banimit në qendrat kolektive dhe në vendbanimet joformale, dhe mungesa e mundësive sociale-ekonomike dhe shqetësimet lidhur me arsimimin. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë grupet më të cenuara. Për personat e zhvendosur romë dhe ashkali që jetojnë në kampet e kontaminuara në veriun e Mitrovicës/Mitrovica, nuk ka zgjidhje të qëndrueshme apo trajtim të duhur mjekësor. Përveç kësaj, mungesa e financimit të duhur për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe bashkërendimi i pamjaftueshëm ndër-institucional ndikon shumë në personat që kthehen me forcë në Kosovë.

Situata në terren

⁷⁹ Më herët, përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në shërbimin civil kishte pasqyruar përqindjen e përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në Kuvendin e Kosovës, sipas Nenit 4 (2) të Rregullores 2001/19 për Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, 13 shtator 2001, ashtu si ishte ndryshuar.

⁸⁰ Më 24 dhjetor 2008, Qeveria e Kosovës miratoi "Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian" kurse plani i veprimit i kësaj strategjie është miratuar më 23 dhjetor 2009.

Gjatë vitit 2009 dhe gjatë muajve të parë të vitit 2010, numri i personave të zhvendosur që ishin kthyer në Kosovë ishte rritur në krahasim me vitin e mëparshëm.⁸¹ Gjithsej 1,153 pjesëtarë të komunitetit joshumicë janë kthyer në Kosovë gjatë vitit 2009 ndërsa 884 persona janë kthyer që nga muaji janar i vitit 2010.⁸² Për herë të parë prej vitit 1999, 15 familje shqiptare të Kosovës janë kthyer në shtëpitë e tyre të porsandërtuara në pjesën veriore të Kosovës dhe tani jetojnë në Brdjani/Kroi i Vitakut, në veri të Mitrovicës/Mitrovica.

Gjithashtu, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2010, 1,509 persona janë riatdhesuar me forcë në Kosovë nga shtetet e Evropës Perëndimore. Gjithsej 271 pjesëtarë të komuniteteve konsiderohet se janë në rrezik dhe kanë nevojë për mbrojtje të vazhdueshme ndërkombëtare nga Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR).⁸³ Me kthimin e 2,962 individëve, rezultoi që në vitin 2009 ka pasur rritje të personave të kthyer me forcë në krahasim me vitin e mëhershëm.⁸⁴ Nga pjesëtarët e komunitetit joshumicë të kthyer, shumica i takojnë komunitetit rom⁸⁵ edhe pse udhëzimet e UNHCR-së për kriteret e përzgjedhjes, të nëntorit të vitit 2009, udhëzojnë vendet pritëse që me kujdes të vlerësojnë nevojat e mbrojtjes për këtë komunitet të cenueshëm.⁸⁶ Më 25 qershor 2010, qeveria e Kosovës e miratoi një ligj për ripranim që është në përputhje në masë të gjerë me kërkesat e Këshillit të Evropës.

Ministria për Komunitete dhe Kthim, me qëllim të thjeshtimit dhe kanalizimit të politikave të kthimit, në muajin tetor të vitit 2008 ka nisur rishikimin e “Doracakut të Shqyrtuar për Kthim të Qëndrueshëm të vitit 2006”. Rishikimi është duke vazhduar. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka finalizuar Strategjinë e saj për Komunitete dhe Kthim për periudhën 2009-2013, që është miratuar nga Qeveria e Kosovës në muajin shkurt 2010. Ministria për Komunitete dhe Kthim, në kuadër të kësaj kornize të politikave, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet vendore dhe aktorët përkatës ndërkombëtar vazhdon të përkrah personat e zhvendosur dhe të kthyer nëpërmjet disa programeve të ndryshme, përfshirë këtu mbikëqyrjen e projektit në zbatim e sipër “Kthimi dhe riintegrim në Kosovë” që financohet bashkërisht me Zyren Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE/ECLO).

⁸¹ Në përgjithësi, në vitin 2006 janë kthyer 1,669 persona, 1,816 persona në vitin 2007 dhe 679 persona në vitin 2008. Pasqyrat statistikore të UNHCR, dhjetor 2009. Shifrat përfshijnë kthimin vullnetar e pjesëtarë të komuniteteve joshumicë dhe kthimin spontan nga vendet e treta.

⁸² Pasqyra statistikore e UNHCR, e azhurnuar në fund të muajit qershor 2010.

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Po aty. Në përgjithësi, 3,569 persona janë kthyer me forcë në vitin 2006, 3,219 persona në vitin 2007 dhe 2,550 persona në vitin 2008.

⁸⁵ Prej 769 personave të kthyer me forcë mes vitit 2009 dhe muajit qershor 2010, 301 janë pjesëtarë të komunitetit romë. Përveç kësaj, 236 pjesëtarë të komunitetit ashkali dhe 10 të komunitetit egjiptian. Pasqyra statistikore e UNHCR, qershor 2010, fq. 7.

⁸⁶ “Udhëzimet e UNHCR për përzgjedhje për vlerësimin e nevojave për mbrojtje ndërkombëtare të individëve nga Kosova” nëntor 2009. Udhëzimet për përzgjedhje përcaktojnë që: “Serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës që banojnë në vendet ku përbëjnë pakicë, dhe romët e Kosovës që banojnë kudo në Kosovë, vazhdojnë të ballafaqohen me kufizime serioze sa i përket lirisë së tyre të lëvizjes dhe ushtrimit të drejtave të tyre themelore. [...] minoriteti ashkali dhe egjiptian, për shkak të karakteristikave të tyre racore dhe etnike, mund të ngatërrohen me romët e Kosovës [...] kërkesat për azil nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve duhet të vlerësohen me kujdes, në mënyrë që të vlerësohet nëse ekziston nevoja për mbrojtje ndërkombëtare bazuar në rrezikun e persekutimit për shkak të racës apo kombësisë së perceptuar”, fq. 17 – 18.

Më 16 dhjetor 2009, ZNKE miratoi një projekt në vlerë prej pesë milion euro për të mundësuar rivendosjen dhe riintegrimin e 90 familjeve romë dhe ashkali që banonin në kampet e kontaminuara në veri të Mitrovicës/Mitrovica. Projekti e plotësoi programin e USAID të nisur në vitin 2008 që arriti ta realizojë me sukses mbylljen e kampit Česmin Lug më 1 tetor. Ky projekt synon mbylljen e plotë të kampeve të kontaminuara me plumb.⁸⁷ Më 11 mars 2010, një ekip i specialistëve nga Universiteti Aberystwyth kishte paraqitur rezultatet e testeve gjithëpërfshirëse të dheut, ujit dhe copëzave të pluhurit në Mëhallën e Romëve. Rezultatet treguan që Mëhalla e Romëve është shumë më pak e kontaminuar me plumb se sa kampet.⁸⁸ Mbyllja e kampeve të kontaminuara me plumb në veri të Mitrovica/Mitrovicës parashihet të bëhet në fund të vitit 2010.⁸⁹

Në muajin shkurt të vitit 2010, Ministria e Punëve të Brendshme ka krijuar një ekip veprimi për shqyrtimin e mekanizmave aktual qendror dhe komunal për personat e riatdhesuar, me qëllim të identifikimit të sfidave dhe boshllëqeve në lidhje me riatdhesimin dhe riintegrimin e tyre. Rezultatet ishin publikuar në muajin prill të vitit 2010.⁹⁰ Ndërkohë Qeveria e Kosovës miratoi “Strategjinë e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar”, me një proces minimal konsultimesh me hisedarët përkatës. Qeveria e Kosovës gjithashtu miratoi një plan të veprimit për zbatimin e strategjisë, duke përfshirë identifikimin e detyrave me prioritet dhe të burimeve të domosdoshme për zbatimin e tij.

Çështjet e mbetura

Në përgjithësi, niveli i kthimit vullnetar është ende i ulët. Deri më tani, vetëm nëntë komuna⁹¹ të Kosovës kanë miratuar strategjinë komunale për kthim për vitin 2010 krahasuar me 19 strategjitë që ishin miratuar në vitin 2009. Megjithatë, zbatimi efektiv i këtyre strategjive vazhdon të jetë, në shumë raste, i penguar nga mungesa e financimit të aktiviteteve dhe projekteve të kthimit, mosgatishmërisë politike, problemeve strukturore dhe për shkak të sfidave ndaj kthimit në terren. Sfidat e tilla janë mungesa reale apo e perceptuar e sigurisë, qasja në shërbimet publike, çështjet e ndërlidhura me të drejtat e pronës dhe të banimit dhe mundësitë sociale-ekonomike. Një tjetër sfidë të madhe paraqet edhe siguri i kushteve të përshtatshme për kthim të sigurt dhe të denjë. Kthimi spontan i shqiptarëve të Kosovës në Brdjani/Kroi i Vitakut, në veri të Mitrovicës/Mitrovica dhe i pjesëtarëve të komunitetit serb në Zallq/Žac, rajoni i Pejës/Peć, janë shembuj të këtyre vështirësive. Në të dyja rastet, sulmet e dhunshme kundër të kthyerve spontan kanë pasur si qëllim ndaljen e zbatimit të procesit të kthimit. Kjo vlen në veçanti për rastin në Brdjani/Kroi i Vitakut, që ka

⁸⁷ Programi i ZNKE parasheh ndërtimin e shtëpive në tokë komunale, të ndarë në jug të Mitrovicës/Mitrovica, përkatësisht në Mëhallën e Romëve, apo ndonjë vend tjetër sipas zgjedhjeve të të zhvendosurve. Programi, që është nisur zyrtarisht më 1 shkurt 2010, përmban pjesën e rivendosjes, dhe të riintegrit të sigurt, ekonomikisht produktiv dhe të shëndetshëm të banorëve të kampit Osterode dhe kampit të dikurshëm Česmin Lug.

⁸⁸ Universiteti i Uellsit “Vlerësim gjeokimik i dheut në Mëhallën e Romëve, Mitrovicë, Kosovë: implikimet e rivendosjes të propozuar të familjeve që jetojnë momentalisht në kampet Osterode dhe Česmin Lug”, Instituti i Gjeografisë dhe Shkencave Tokësore, Universiteti i Uellsit, Aberystwyth, mars 2010. Në dispozicion edhe në: <http://ukinkosovo.fco.gov.uk/resources/en/pdf/report>.

⁸⁹ Më 1 tetor 2010, pas periudhës së raportimit, kampi Česmin Lug zyrtarisht është mbyllur.

⁹⁰ Ministria e Punëve të Brendshme, “Vlerësim i mekanizmave për riintegrimin e personave të riatdhesuar – siguri i trajtimit më të mirë të mundshëm dhe respektimi i të drejtave të njeriut i të gjithë personave të riatdhesuar”, prill 2010.

⁹¹ Novo Brdo/Novobërdë, Vushtrri/Vučitrn, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Shtime/Štimlje, Dragash/Dragaš, Suharekë/Suva Reka.

ndodhur gjatë periudhës së raportimit, ku konflikti ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës nxiti intervenimin e Policisë së Kosovës dhe asaj të EULEX si dhe përdorimin e gazit lotsjellës. Një incident serioz ndodhi më 4 janar 2010, kur një grup prej 40 serbëve të Kosovës sulmuan punëtorët shqiptar të Kosovës dhe ia futën flakën automjetit të tyre. Në mes të muajve shkurt dhe qershor të vitit 2010, banorët shqiptarë të Kosovës nga fshati i përzier etnikisht të Zallqit/Žač, kanë gjuajtur me gurë dhe armë zjarri tendat e të kthyerve spontanë serbë të Kosovës që po prisnin rindërtimin e shtëpive të tyre. Projekt i rindërtimit u nis në fillim të korrikut mirëpo në mes të gushtit u shkatërruan disa mure të ngritura pjesërisht dhe u vunë në zjarr fushat në afërsi të kampit të të kthyerve. Pas këtyre ngjarjeve, policia e Kosovës e zhvilloi një plan operativ për ta shtuar sigurinë për të kthyerit serbë të Kosovës në zonë dhe zhvilloi aktivitete shtesë për parandalimin e incidenteve duke i shtuar masat kontrolluese. KFOR-i ka prani të përhershme në vendet e rindërtimit. Prej atëherë, nuk është raportuar për ndonjë incident tjetër.

Institucionet e Kosovës kanë ndërmarr shumë pak veprime për të zbatuar objektivat e “Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar” në nivel komunal.⁹² Ende nuk është ndërmarr ndonjë hap konkret për të lehtësuar riintegrimin e personave të riatdhesuar në fushat kryesore, siç janë shëndetësia, arsimimi, punësimi dhe banimi, ndërsa shpenzimet për riintegrimin e personave të riatdhesuar nuk janë përfshirë në buxhetet përkatëse komunale. Si pasojë, personat e riatdhesuar nuk marrin ndonjë ndihmë kuptimplote pas ardhjes së tyre në Kosovë.

Kampet e kontaminuara në veri të Mitrovicës/Mitrovica ekzistojnë ende përkundër përkrahjes nga hisedarët vendor dhe ndërkombëtar për t’i mbyllur ato.⁹³ Në fakt, kampi Česmin Lug nuk është mbyllur në tërësi deri më 1 tetor. Programet e ZNKE dhe USAID kanë mbuluar vetëm kampet Osterode dhe Česmin Lug në veri të Mitrovicës/Mitrovica, kurse nuk është paraparë një zgjidhje për banorët e kampit në Leposavić/Leposaviq. Në lidhje me rivendosjen e qëndrueshme, disa të meta që duhet të adresohen janë: udhëheqësit e komunitetit dhe përfituesit potencial nuk janë edhe aq shumë të përfshirë në procesin e vendimmarrjes; plani urban komunal i Mitrovicës/Mitrovica për zbatimin e projekteve të rivendosjes nuk i përmbush kërkesat ligjore; rregullimi i vendbanimeve joformale nuk është diskutuar ende; komuniteti pretendon që madhësia e disa prej shtëpive të ndërtuara është tepër e vogël për të ofruar kushte të mira jetese, dhe pjesëtarët e komunitetit nuk kanë njohuri për pjesët tjera të projektit, siç janë trajtimi mjekësor, fuqizimi ekonomik dhe arsimimi. Të gjitha këto elemente ndikojnë në marrëdhënien tashmë të brishtë ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe personave të zhvendosur, duke rrezikuar kështu rivendosjen e suksesshme të banorëve romë dhe ashkali nga kampet e kontaminuara me plumb.

7. PËRFUNDIME

Në periudhën mes muajit korrik 2009 dhe qershor 2010, institucionet e Kosovës kanë shënuar pak përparim në zbatimin e legjislacionit gjithëpërfshirës dhe të sofistikuar që

⁹² Raport i OSBE-së, *Zbatimi i Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Komunitet e Kosovës*, nëntor 2009. http://intranet/n/s/documents/monitoring/4/09120403_1357_en.pdf.

⁹³ Për shembull, më 15 shkurt 2010 Komisionari i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut kishte përsëritur domosdoshmërinë e evakuimit të menjëhershëm të familjeve që banojnë në kampe. http://www.coe.int/t/commissioner/news/2010/100215kosovo_EN.asp.

ishite miratuar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë. Megjithatë, nevojitet një përkushtim më i madh institucional për respektimin e plotë të drejtave të komuniteteve joshumicë dhe për zbatimin e mjaftueshëm të rekomandimeve të Komitetit Këshillues të Këshillit të Evropës dhe rekomandimeve të OSBE-së në lidhje me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Korniza ligjore për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare vazhdon të jetë kryesisht e pazbatuar. Institucionet kompetente vazhdojnë të deshtojnë që të përpilojnë dhe miratojnë një listë gjithëpërfshirëse të monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Ende nuk janë themeluar e as miratuar mekanizmat e domosdoshëm për zbatimin e kornizës ligjore dhe legjislacionit të domosdoshëm komunal. Incidentet që kanë si cak monumentet e trashëgimisë kulturore dhe fetare, vazhdojnë të ndodhin në vende ku siguria tani monitorohet nga Policia e Kosovës.

Një ndër sfidat më të mëdha për të siguruar një shoqëri stabile dhe tolerante është mungesa e ndërveprimit ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve të komuniteteve të ndryshme, posaçërisht ndërmjet pjesëtarëve të komunitetit shqiptar dhe atij serb të Kosovës. Një faktor serioz që kontribuon në vështirësimin e ndërveprimit të tillë është mungesa e mundësive për t'i studiuar të dy gjuhët zyrtare të Kosovës. Shumë nxënës dhe studentë të komuniteteve joshumicë nuk kanë qasje të plotë në arsim për shkak të mungesës së librave shkollorë në gjuhët e komuniteteve joshqiptare, si dhe të cilësisë së dobët të përkthimit. Në mënyrë të ngjashme, zbatimi i strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kërkon përpjekje më konkrete dhe burime adekuate financiare.

Shqetësime kryesore vazhdojnë të jenë mbikëqyrja e pamjaftueshme e legjislacionit për gjuhët nga institucionet qendrore dhe komunale, ndarja joadekuate e burimeve financiare dhe njerëzore si dhe cilësia e dobët e përkthimeve në gjuhët zyrtare. Komisioni për Gjuhë ka nevojë për mbështetje politike dhe financiare për ta rritur praninë dhe efektivitetin e tij si dhe që eventualisht ta zbatojë mandatin e tij.

Niveli i punësimit të komuniteteve joshumicë në Shërbimin Civil të Kosovës mbetet i pamjaftueshëm. Ulja e përqindjes së kërkuar të përcaktuar me ligj nuk do të sjellë kurrfarë zhvillimi pozitiv. Punësimi i komuniteteve joshumicë në organet komunale është në nivel të pakënaqshëm, për shkak se ata janë në përgjithësi të përjashtuar nga jeta publike dhe nga mekanizmat e vendimmarrjes. Po ashtu, duhet të ndërmerren përpjekje të konsiderueshme për të promovuar, inkurajuar si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komuniteteve joshumicë, posaçërisht të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Një sfidë tjetër e madhe është sigurimi i kushteve të duhura për një proces të sigurt dhe të denjë të kthimit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur. Faktorët vendimtar që ende ndikojnë në marrjen e vendimit për tu kthyer janë mungesa e financimit dhe e vullnetit politik, qasja e kufizuar në shërbimet publike dhe në ushtrimin e të drejtave të pronës dhe banimit si dhe të mundësive sociale-ekonomike dhe të shqetësimeve reale apo të perceptuara të sigurisë. Masat e miratuara për t'i ofruar ndihmë personave të riatdhesuar me forcë janë të pamjaftueshme. Gjatë procesit të mbylljes së kampeve, duhet të konsultohen dhe duhet t'u ofrohet një zgjidhje e bazuar në të drejtat e tyre, si edhe trajtim emergjent mjekësor, banorëve romë dhe ashkali të kampeve të kontaminuara me plumb në veri të Mitrovicës/Mitrovica dhe në Leposavić/Leposaviq.

8. REKOMANDIMET

Në bazë të asaj që u tha më lart, OSBE-ja rekomandon që institucionet e Kosovës t'i marrin në konsideratë të mëposhtmet:

- Të përpilohet një liste gjithëpërfshirëse e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare, si dhe monumenteve tjera që përfaqësojnë trashëgiminë e larmishme historike në Kosovë në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke inkorporuar gjërat me rëndësi për komunitetet joshumicë, personat e zhvendosur dhe grupet e tjera të cenueshme;
- Të sigurohet që çfarëdo pranim-dorëzim i kompetencave të sigurisë nga KFOR-i tek Policia e Kosovës për monumentet e Kishës Ortodokse Serbe, nuk e minon sigurinë, funksionimin dhe qasjen në këto vende;
- Të vazhdohet me sigurimin e arsimit në gjuhët e komuniteteve joshqiptare dhe të shtohen përpjekjet për të ofruar arsimim në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës;
- Të sigurohet financim i duhur dhe përkrahje politike për zbatimin efektiv të të gjitha fushave tematike të strategjisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, dhe në veçanti të pjesës së strategjisë që ka të bëjë me arsimin;
- Të shtohet prania e Komisionit për Gjuhë dhe të fuqizohet ai si organ dhe mekanizëm kryesor i mbikëqyrjes dhe ankimit në lidhje me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve;
- Të ndërmerren hapa për të siguruar që pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë u lëshohen dokumentet personale pa gabime drejtshkrimore dhe që ata kanë mundësinë për t'iu qasur shërbimeve publike në gjuhët zyrtare, nëpërmjet avancimit të njësive të përkthimit në kuadër të institucioneve;
- Të ndërmerren masa të qëndrueshme për të inkurajuar dhe promovuar punësimin e komuniteteve joshumicë në shërbimin civil dhe në mekanizmat e vendimmarrjes, duke realizuar fushata dhe aktivitete të informimit, arsimimit dhe trajnimeve për komunitetet joshumicë;
- Të ofrohen kushte të duhura për kthim të sigurt dhe të denjë të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, që ende janë të zhvendosur, përmes masave konkrete për mundësimin e qasjes në pronë, banim dhe mundësi sociale-ekonomike;
- Të ndahen burime financiare dhe të shtohen në maksimum përpjekjet për sigurimin e bashkërendimit ndërmjet të gjitha institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kornizës për ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës për personat e riatdhesuar me forcë;
- Të zbatohet, si çështje me prioritet, një zgjidhje e qëndrueshme dhe e bazuar në të drejtat e njeriut për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali që jetojnë ende në kampet e kontaminuara me plumb, duke i përfshirë ata në dialog dhe në procesin e vendimmarrjes.